



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 41, datë 09.05.2022

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE NË
BASHKINË Durrës

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë.17.12.2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr. 195, datë 20.04.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Rregullores për administrimin e mbetjeve në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores së administrimit të mbetjeve në Bashkinë Durrës sipas dokumentacionit bashkëlidhur, miratuar nga titullari i institucionit.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës dhe Ndërmarrjen Komunale Plazh.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 10.05.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Nr. 3526 / prot
/ 2

Durrës, më 04.5 2022



MIRATOI
KRYETAR
EMIRIANA SAKO

RREGULLORE

**PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE URBANE DHE PASTRIMIT TË QYTETIT
DURRËS.**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 dt.17/12/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Ligjit Nr.10431, datë 09.07.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" i ndryshuar, Ligjit Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”; VKM-së nr. 967, datë 25.10.2013, pika 4/c “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, VKM-së nr.418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e Dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, VKM-së Nr. 389, datë 27.06.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në Nr.452, datë 11.07.2012 "Për Lendfilllet e mbetjeve", Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 06, datë 13.01.2020 “Për miratimin e lejes së infrastrukturës: “Mbyllja e vendepozitimit të mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i ECO-PARK me vendndodhje në Bashkinë Durrës”, Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”.

2022

TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I..... **DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME MBI ADMINISTRIMIN E MBETJEVE TË** **NGURTA URBANE**

1. Qëllimi.....
2. Objekti i rregullores.....
3. Zbatimi i rregullores.....
4. Përkufizime.....
5. Administrimi i mbetjeve të ngurta urbane.....
6. Fazat e administrimit të mbetjeve të ngurta.....
7. Klasifikimi i mbetjeve.....
8. Mbetjet objekt i rregullores.....

KREU II..... **PASTRIMI I RRUGËVE, SHESHEVE DHE TROTUAREVE**

1. Të përgjithshme.....
2. Pastrimi i territoreve.....
3. Pastrimi dhe larja e rrugëve.....
4. Koshat rrugorë.....
5. Pastrimi i pusetave dhe dorëzimi i mbetjeve të pastrimit.....
6. Ndotja e hapësirave publike.....
7. Manifestimet publike, panairët, spektaklet lëvizëse dhe veprimtari të stinës.....

KREU III..... **VECIMI, SISTEMIMI DHE DORËZIMI I MBETJEVE URBANE**

1. Vecimi dhe sistemimi i mbetjeve urbane.....
2. Dorëzimi i mbetjeve urbane.....
3. Përdorimi i kontenierëve publik.....
4. Kufizimet për dorëzimin e mbetjeve urbane.....

KREU IV..... **GRUMBULLIMI, LARGIMI E TRANSPORTI I MBETJEVE URBANE**

1. Grumbullimi i mbetjeve urbane.....
2. Grumbullimi me kontenierë.....
3. Grumbullimi me qese.....
4. Grumbullimi me kontenierë të palëvizshëm.....
5. Shërbimi i pastrimit në tregje.....
6. Vendosja dhe karakteristikat e kontenierëve.....
7. Ruajtja higjieno – sanitare për punonjësit e shërbimit.....
8. Transporti i mbetjeve urbane.....
9. Peshimi i mbetjeve urbane.....

KREU V..... **ADMINISTRIMI I MBETJEVE URBANE NË MËNYRE TË DIFERENCUAR DHE** **QENDRAT E MULTIGRUMBULLIMIT**

1. Objekti i shërbimit dhe parimet e përgjithëshme.....
2. Mënyra e dorëzimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane në mënyre të diferencuar..

3. Grumbullimi i diferencuar.....
4. Standarte mbi grumbullimin e mbetjeve urbane nepërmjet konteniereve.....
5. Grumbullimi i mbetjeve të pariciklueshme të parrezikshme.....
6. Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme të parrezikshme.....
7. Grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme familjare.....
8. Grumbullimi i mbetjeve të vëllimshme.....
9. Qëndrat e multi - grumbullimit.....
10. Hapja e qendrave të multi – grumbullimit.....

KREU VI.....

TARIFAT

1. Vjelja e tarifës.....
2. Taksapaguesit.....

KREU VII.....

MARRËDHENIET ME PUBLIKUN

1. Detyrimi për informim.....
2. Fushatat sensibilizuese dhe informuese.....
3. Bashkëpunimi me organizmat joqeveritare.....

KREU VIII.....

ORARET E HEDHJES SË MBETJEVE PËR FAMILJARËT, ENTET PUBLIKE DHE BIZNESET

1. Përcaktimi i orareve për secilën kategori.....

KREU IX

NDALIMET, KONTROLLI DHE SANKSIONET.

1. Ndalime dhe detyrime.....
2. Kontrolli
3. Sanksionet



KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHËSHME MBI ADMINISTRIMIN E MBETJEVE TË NGURTA URBANE

Neni 1

Qëllimi

Duke detajuar të drejtat dhe detyrat e të gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, rregullorja synon të lehtësojë zbatimin e kërkesave të legjislacionit të kësaj fushe dhe të mundësojë një kontroll efektiv në zbatimin e tyre.

Neni 2

Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton mënyrën e administrimit të mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Durrës, duke saktësuar rregullat, teknikat dhe metodat e administrimit të tyre në çdo fazë të këtij administrimi, pa përfshirë trajtimin e mbetjeve, me qëllim mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja e shkaktuar nga mbetjet urbane dhe mbajtjen e një mjedisi të shëndetshëm për qytetin e Durrësit.

Neni 3

Zbatimi i rregullores

Zbatimit të kësaj rregulloreje i nënshtrohen:

- Institucionet shtetërore dhe organizmat vendorë,
- Gjithë individët, banorë të qytetit e njësi administrative, kalimtarë të rastësishëm, turistë e pushues, shtetas të huaj rezident në qytet, punonjës në organe e organizma publike e private.
- Gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, tregtare, shoqërore, arsimore, kulturore, artistike, shëndetësore, turistike.
- Personat juridikë e fizikë, publikë e privatë, vendas apo të huaj, të angazhuar me kontratë dhe të licensuar për grumbullimin, depozitimin, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave

Neni 4

Përkufizime

Në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues mbi administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin, si në nenin 4 në ligjin nr. 8094 datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave" dhe në nenin 3

të Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" në kuptimin e kësaj rregullore vlejné përkufizimet e mëposhtme:

1. "**mbeturina**" janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaria njerëzore ose ciklet natyrore të destinuara për braktisje.
2. "**mbetje shtëpiake**" janë mbetjet e sektorit familjar nga komunat, bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera që, për shkak të natyrës ose përbërjes së tyre, janë të njëjta me mbetjet shtëpiake nga komunat, bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre.
3. "**mbetje e ngurtë**" është një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoret më ose që zotëruesi do t'i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihet në procesin e prodhimit.
4. "**mbetje bio**" janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, kateringut dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.
5. "**mbetje të rrezikshme**" janë mbetjet toksike gërryese, ngacmuese, shpërthyes, të përfllakshme, kancerogjene, infektive dhe radioaktive që kanë vetinë të prishin gjëndjen natyrore të tokës, ujit dhe ajrit, me pasoja në shëndetin e njeriut dhe në ekosistemet natyrore; "mbetje të rrezikshme nga përdorimi shtëpiak" janë : bojra për lyerje, bojra shkrimi, ngjites, tretës,produkte fotokimike, pesticide, mbajtës makinash, ilace, shiringa, aksesore për informatikën, vajra mineral, vajra vegjetal, tuba fluorishent dhe çdo lloj mbetje me përmbajtje mërkuri.
6. "**mbetje inerte**" janë ato mbetje, që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte duhet të jenë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk duhet të jenë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore. Ato përfshijnë mbetjet si: gurë, dhera, beton, tulla, që mbeten nga veprimtaritë ndërtime, rindërtuese, meremetuese dhe prishëse të ndërtesave dhe strukturave të tjera.
7. "**mbetje e lëngshme**" është çdo mbetje në trajtë të lëngshme, përfshirë ujërat e përdorura, por përjashtuar llumrat.
8. "**mbetje të vëllimshme**" janë mbetjet me përmasa të mëdha pajisjesh e makinerish, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave kryhet me metoda e teknik të veçanta; përfshihen objektet e mëdha, të mirat me konsumim të qëndrueshëm si: elektroshtëpiake, pajisje informatike, mobilje, pjesë autoveturash, penobetone, metale dhe mbeturina të tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave pengojnë përdorimin e metodave të zakonshme të mbledhjes, transferimit ose hedhjes se tyre.
9. "**mbetje të ambalazheve**" janë të gjitha ambalazhet ose materialet e tyre që mbuloen nga përkufizimi i mbetjes në këtë ligj, me përjashtim të tepricave që mbesin nga prodhimi i tyre.

10. "**mbetjet nga gomat e përdorura**" janë mbetjet që krijohen kur gomat e vjetëruara, të dëmtuara, që janë zëvendësuar dhe kur automjetet arrijnë në fundin e jetës së tyre.
11. "**mbetje**" është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.
12. "**person**" është çdo person fizik ose juridik.
13. "**prodhuesi i mbetjeve**" është personi fizik dhe juridik, veprimtaria e të cilit krijon, prodhon mbetje.
14. "**administrim i mbetjeve të ngurta urbane**" është grumbullimi, transporti, rekuperimi dhe trajtimi i mbetjeve, duke përfshirë edhe kontrollin e këtyre operacioneve, për më tepër edhe kontrollin e fushave të shkarkimit dhe impianteve të trajtimit pas mbylljes së aktivitetit.
15. "**operator i shërbimit**" është shoqëria/ ndërmarja, të cilës nëpërmjet kontratave të shërbimit, licensave (lejeve), bashkia i beson dhe /ose lejon administrimin e mbetjeve të ngurta urbane.
16. "**dorëzimi**" quhet nxjerrja dhe hedhja e mbeturinave urbane nga prodhuesit e tyre në vendet e mbledhjes së mbetjeve të ngurta urbane.
17. "**grumbullimi i mbetjeve të ngurta urbane**" quhet procesi i pranimit, seleksionimit dhe rigrupimit të mbetjeve në vende të caktuara.
18. "**ndarje e mbetjeve në burim**" ndarja e mbetjeve urbane në pjesë të ndryshme merceologjike për të lejuar rekuperimin dhe/ose ripërdorimin
19. "**grumbullim i diferencuar**" grumbullimi i përshtatshëm, për rigrupimin e mbetjeve urbane në fraksione merceologjike homogjene, duke përfshirë fraksionin organik të lagësht, të destinuar për ripërdorim, për riciklim dhe rekuperim të lëndës së parë.
20. "**grumbullim me kontenierë publik**"; operacioni i largimit të mbetjeve në pika grumbullimi fikse, paraprakisht të përcaktuara nga bashkia, jashtë vendeve të prodhimit të mbetjes, ku prodhuesi dorëzon direkt mbetjen.
21. "**largim publik i mbetjeve të ngurta urbane**" quhet procesi i dorëzimit, mbledhjes, transportimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane.
22. "**vend-depozitimi i mbetjeve**" është sipërfaqe toke e caktuar nga organet e qeverisjes vendore për përpunimin dhe manipulimet që do të realizohen.
23. "**qëndër multigrumbullimi**" janë pika grumbullimi të ruajtura, të destinuara për dorëzimin e materialeve të rikuperueshme, të rrezikshme ose voluminoze të mbetjeve urbane. Këto qëndra përcaktohen nga administratori i shërbimit në zonë të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme.
24. "**shesh ekologjik**" është sipërfaqe e betonuar, me strukturë të përshtatshme, për dorëzimin e mbetjeve të vëllimshme. Këto sheshe ndërtohen nga administratori i shërbimit në zonë të përshtatshme.
25. "**rikuperim**" janë operacione për të siguruar shfrytëzimin e mbetjeve për përfitimin e produkteve, lëndëve të para ose prodhimin e energjisë.
26. "**riciklim i mbetjes**" është ripërtëritja ose rinovimi i vetive të mbetjes për tu përdorur më pas si lëndë e parë ose si material ndihmës.
27. "**stokimi i mbetjeve**" quhet procesi i ruajtjes (depozitimit) të produktit pas përpunimit të mbetjes deri në destinacionin përfundimtar.

28. "**pastrimi i rrugëve**" quhet shërbimi publik manual ose mekanizimi i heqjes së mbetjeve të rëna në rrugë apo hapësira publike, duke përfshirë këtu parqe dhe hapësira të gjelbërta, ose rrugë dhe hapësira private gjithsesi objekt i përdorimit publik.
29. "**zonë e kontratës**" quhet zona brënda kufijve të vijës së verdhë, ku kontraktuesi do të sigurojë shërbimin e administrimit të mbetjeve ndaj konsumatorëve ekzistues, si dhe atyre që mund të shtohen gjatë kohështirjes së kontratës brënda të njëjtës zonë. Kufijtë e zonës së kontratës përcaktohen nga bashkia.
30. "**zonë e larjes**" quhet shërbimi i larjes së rrugëve dhe në disa raste të trotuareve.

Neni 5

Administrimi i mbetjeve të ngurta urbane

1. Proçesi i administrimit të mbetjeve synon që:

Të rezultojnë sa më pak mbetje nga veprimtaritë prodhuese. Në mbetjet e krijuara, të zënë vendin kryesor mbeturinat e degradueshme, të riciklueshme e të përpunueshme.

- a) Të përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundëshme të bazuara në kriteret mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve.
 - b) Të realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbetjeve me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis.
 - c) Mbetjet t'i nënshtrohen sa më shumë riciklimit dhe përpunimit.
 - d) Të grumbullohen dhe të trajtohen të ndara mbetjet në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbetjet e rrezikshme.
 - e) Të pakësohet sa më shumë lëvizja dhe transporti i mbetjeve dhe asgjësimi i tyre të kryhet në impiantin më të afërt.
 - f) Të parandalohet ndotja nga mbetjet dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh.
 - g) Të ruhen burimet natyrore nga ndikimet e mbetjeve.
 - h) Të dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizik dhe juridik ndotja dhe dëmtimi, që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbetjeve.
 - i) Të kryhet groposje e sigurt për hedhurinat që rezultojnë pas përpunimit të mbetjeve.
 - j) Të mënjanohet çdo dëm a rrezik për shëndetin mirëqënien dhe sigurinë e jetës së personit.
 - k) Të garantohen kërkesat higjieno-shëndetësore dhe të mënjanohet çdo rrezik për ndotjen e mjediseve urbane.
 - l) Të ruhet flora, mjedisi e pejsazhi nga degradimi.
2. Të gjitha llojet e mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë rregullore, pas dorëzimit të tyre janë pronë shtetërore.

Neni 6

Fazat e administrimit të mbetjeve të ngurta

Proçesi i administrimit të mbetjeve urbane përfshin krijimin, grumbullimin, ruajtjen dhe sistemimin e tyre nga prodhuesi i mbetjeve, dorëzimin sistematik në kontenierë, largimin nga kontenierët për në vend-depozitimin, ndarjen, riciklimin, dhe përpunimin përfundimtarë.

Neni 7

Klasifikimi i mbetjeve

1. Në funksion të kësaj rregullore, mbetjet ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Mbetje Urbane
- Mbetje industriale
- Mbetje të vëllimshme
- Mbetje bujqësore
- Mbetje spitalore
- Mbetje të ndërtimit
- Mbetje të rrezikshme
- Mbetje të sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza, etj

2. Sipas origjinës së prodhimit mbetjet grupohen në mbetje urbane dhe mbetje speciale. Sipas cilësive të rrezikshmërisë ndahen në mbetje të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

3. Në mbetjet speciale përfshihen:

"mbetjet nga aktivitetet industriale"
"mbetjet e vëllimshme",
"mbetjet nga aktivitetet bujqësore",
"mbetjet spitalore",
"mbetjet e ndërtimit",
"mbetje të rrezikshme",

Neni 8

Mbetjet objekt i rregullores



1. Objekt i kësaj rregulloreje janë mbetjet urbane,
2. Në funksion të kësaj rregulloreje, mbetjet urbane i ndajmë në dy kategori:
Mbetje urbane të riciklueshme dhe të parrezikshme, të cilat përfshijnë mbetjet urbane, të cilat mund të ripërdoren ose riciklohen (mund të përpunohen duke u vënë në përdorim si lëndë e parë). Në këtë kategori përfshihen:
 - a. Mbetjet metalike

- b. Mbetjet e lulishteve, kopështeve
- c. Mbetjet plastike
- d. Letra dhe kartoni
- e. Shishet e qelqit (qelqurinat)
- f. Mbetje urbane të pariciklueshme dhe të parrezikshme, si psh: mbetjet ushqimore (organike) dhe kuzhine me përbërje të fermentueshme, etj, të cilat përmbledhin të gjitha mbetjet urbane, që nuk përfshihen në kategorinë e mbetjeve urbane të riciklueshme.

Neni 9

Mbetjet, që prodhohen nga ekonomitë familjare, por që nuk përfshihen në mbetjet urbane, si për shembull: mbetjet e rrezikshme, mbetjet nga ndërtimi apo prishja e ndërtesave dhe objektet e vëllimshme, transportohen nga vetë prodhuesit e tyre në fushat përkatëse të depozitimit, të përcaktuara nga bashkia, përkatësisht për secilën prej mbetjeve. Bashkia mund të ofrojë pika alternative për grumbullimin e tyre.

KREU II PASTRIMI I RRUGËVE, SHESHEVE DHE TROTUAREVE

Neni 10 Të përgjithëshme

1. Bashkia përcakton dhe publikon grafikun e pastrimit të rrugëve, shesheve dhe trotuareve.
2. Pastrimi i rrugëve, shesheve dhe trotuareve bëhet përgjithësisht një herë në 24 orë, herët në mëngjes ose në orët e mbrëmjes, kur është ulur ndjeshëm aktiviteti qytetar.
Gjatë ditës pastërtia sigurohet duke grumbulluar dhe larguar nga sheshet, rrugët e trotuaret, mbetjet e ngurta të kalimtarëve, si dhe ndotjet e tjera.

Neni 11 Pastrimi i territorit

1. Hapësirat dhe territoret private pastrohen nga vetë pronaret e tyre.
2. Hapësirat e zbuluara publike, që nuk janë të përfshira në skemën e pastrimit të qytetit, pastrohen nga institucionet ose banorët, që janë përdorues të kësaj hapësire.
3. Personat fizike dhe juridike, që kryejnë veprimtari stacionare ose ambulatore, biznes apo çdo veprimtari tjetër, si dhe ata që kryejnë veprimtari transporti, detyrohen të pastrojnë territorin përreth lokalit apo vendit tyre të punës në gjerësi 2-5 m.
4. Hapësirat e zbuluara publike të përfshira në skemën e pastrimit, pastrohen nga operatori i shërbimit që caktohet nga bashkia.
5. Sheshet e tregëtimit pastrohen çdo ditë nga administratorët ose përdoruesit e tyre, menjëherë pas përfundimit të aktiviteteve.

6. Nëse pronari/ administratori apo përdoruesi i territorit privat apo në përdorim, nuk kryen aktivitetin e pastrimit apo bëhet shkak për ndotje të territorit, bashkia ka të drejtë të njoftojë dhe më pas të sanksionojë kundravajtësin. Bashkia mund të kompensojë aktivitete pastruese nëse mundëson ngarkimin e shpenzimeve ndaj pronarit/ administratorit për aktivitetet e domosdoshme të pastrimit.

Neni 12

Pastrimi dhe larja e rrugëve

1. Pastrimi dhe larja e rrugëve realizohet nga bashkia ose një palë e tretë e ngarkuar prej saj apo e kontraktuar për të kryer këtë shërbim. Në kontratë specifikohen të gjitha kushtet dhe kërkesat që ka bashkia për pastrimin, kontrollin për zbatimin e tyre, si dhe sanksionet për shkeljen e kërkesave të kontratës.
2. Pastrimit i nënshtrohen të gjithë rrugët e asfaltuara, rrugët me kalldrëm, sheshet si dhe trotualet e qytetit dhe të qendrës së banuar.
3. Administratori i shërbimit parashikon të administrojë të gjithë sipërfaqet e gjelbërta publike, të kryejë mirëmbajtjen, ruajtjen dhe pastrimin e territorit nga mbetjet.
4. Përdorimi i uniformave për punëtorët dhe trajtimi special në përputhje me normat higjieno – sanitare është rigorozisht i detyrueshëm.
5. Periodiciteti i shërbimit të pastrimit përcaktohet nga bashkia sipas nivelit të ndotjes që shkaktohet dhe nevojës sipas sezoneve.

Neni 13

Përcaktimi dhe mënyra e larjes së rrugëve

1. Rrugët dhe sheshet kryesore lahen çdo ditë pas pastrimit. Gjatë periudhës së nxehtë (prill – tetor) mund të bëhet larja disa herë në ditë. Numri i larjeve përcaktohet sipas sezonit dhe kushteve konkrete. Për larjen përdoret uji me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100 ml ujë. Në këto raste mund të përdoret edhe uji i puseve, lumenjve ose baseneve të tjerë ujorë.
2. Bashkia përcakton rrugët dhe sheshet që duhet të lahen. Për larjen e rrugëve përdoren automjete të posaçme.

Neni 14

Menaxhimi i mbetjeve urbane

1. Mbetjet urbane, që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuaeve dhe shesheve, hidhen në pikat më të afërta të grumbullimit të mbetjeve urbane sipas llojit të mbetjeve që prodhohen.
2. Ndalohet kategorikisht dorëzimi i mbetjeve urbane që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuaeve dhe shesheve në pusetat e elektrikut, telefonisë, ujësjellesit e ujërave të zeza e hidranteve, në zgarat e pusetave të ujërave atmosferiokë, në shtretërit e ujërave rrjedhëse, në basenet ujore natyrale apo artificiale.

Neni 15

Koshat rrugorë

1. Me qëllim për të garantuar mbajtjen pastër të hapësirave publike mund të vendosen dhe të administrohen nën kujdesin e ndërmarrjeve shërbimeve komunale ose operatorit të shërbimit, koshat rrugorë për mbetjet urbane të dimensioneve të reduktuara të prodhuara nga kalimtarët.
2. Kalimtarët, mbetjet e çastit si amballazhe të ndryshme, i dorëzojnë vetëm në koshat e vendosura në qytet ose që ndodhen pranë dyqaneve. Hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Neni 16

Pastrimi i pushtave dhe dorëzimi i mbetjeve të pastrimit

1. Zhbllokimi dhe pastrimi i pushtave të rrugëve dhe rrjetit të kullimit bëhet vetëm nga punonjësit e subjektit të ngarkuar me administrimin e tyre.
2. Përpara sezonit të shirave kryhet pastrimi i gjithë pushtave të ujërave atmosferik, për të siguruar në vazhdimësi transportin e tyre. Pas çdo pastrimi hiqen menjëherë mbetjet, që dalin nga pastrimi dhe kryhet dezinfektimi përreth pushtës me lëndë dezinfektuese ose pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori.
3. Mbetjet e nxjerra nga pastrimi i pushtave largohen menjëherë nga subjekti përgjegjës dhe depozitohen në vendet e përcaktuara nga bashkia.
4. Të bëhet larja dhe dizinfektimi i vendit dhe nxjerrja e mbetjeve me solucion.

Neni 17

Ndotja e hapësirave publike

1. Kush kryen operacione ose/ dhe aktivitete, të cilat mund të sjellin ndotjen e hapësirave publike, është i detyruar në mënyrë konstante të mbajë të pastër ato çka përmendëm më sipër, në çdo rast, dhe të mos lërë asnjë mbetje të çfarëdo lloji.
2. Ndalohet hedhja dhe derdhja në trotuar, rrugë e sheshe të qëndrave të banuara e mbeturinave dhe ujërave, që dalin nga pastrimi ose larja e lokaleve të shërbimit.

Neni 18

Manifestimet publike, panairt, spektaklet lëvizëse dhe veprimtari të stinës

1. Veprimtaritë e stinës, Entet Publike ose Fetare, Fondacionet apo Shoqatat, Cirqet, Partitë Politike, apo çfardolloj grupi qytetarësh, që kanë për qëllim organizimin e nismave si: festa, panairt, festime popullore, vrapime, spektakle lëvizëse ose manifestime edhe të llojit kulturor apo sportiv, etj, në rrugë, sheshe dhe hapësira publike apo për përdorim publik, janë të detyruar të sigurojnë direkt ose nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta me ndërmarrjet shtetërore ose/dhe operatorin e shërbimit, mbajtjen pastër të hapësirave, që i janë dhënë

atyre për përdorim, si gjatë ashtu edhe në fund të nismës, duke dorëzuar në kontenerët e përshtatshëm të vendosur për këtë qëllim nga administratori, si mbetjet e prodhuara direkt nga aktiviteti i tyre ashtu edhe ato të prodhuara nga frekuentimi i manifestimeve prej qytetarëve.

2. Detyrimet suplementare të dala nga kryerja e shërbimit publik, do ti ngarkohen organizuesve të manifestimeve.

KREU III VEÇIMI, SISTEMIMI DHE DORËZIMI I MBETJEVE

Neni 19

Veçimi dhe sistemimi i mbetjeve urbane

1. Familjet, subjektet private dhe publike, që krijojnë mbetje gjatë veprimtarisë së tyre, i ndajnë ato në grupe si :
 - a. Mbeturina ushqimore (organike)
 - b. Amballazhe (plastike, qelq, letër, karton)
 - c. Metalike të përmasave të vogla.
2. Secili grup trajtohet e ambalazhohet më vete, në qeska a kosha të veçantë. Materialet e riciklueshme mund të grumbullohen në sheshe të rrethuara me tel gabion për tu tërhequr nga firmat e riciklimit. (veçanërisht për materialet e plastikës dhe kartonit)
3. Mbetjet e vëllimshme (si automjete, makineri, pajisje, karrige, tavolina, kolltuqe), mbeturina të materialeve të ndërtimit (mbetje inerte: llac, tulla, beton, dhera) dërgohen nga pronarët e tyre në vendin e përcaktuar nga bashkia për depozitimin dhe përpunimin e tyre. Braktisja e tyre jashtë vendeve të përcaktuara, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Neni 20

Mënyra e vendosjes së kontenerëve

1. Të gjithë subjektet, që në përputhje me natyrën e veprimtarisë së tyre, krijojnë lloje të ndryshme mbetjesh urbane, janë të detyruar të kenë më shumë se një kosh për grumbullimin e ndarë të tyre.
2. Koshat janë me ngjyra të ndryshme ose me mbishkrime të dukshme që orientojnë hedhjen e veçuar të mbetjeve urbane. Koshat vendosen në vende të dukshme dhe lehtësisht të përdorëshme.
3. Spitalet, ambulancat, qendrat shëndetësore, laboratorët, farmacitë, klinikat stomatologjike, shtetërore e private, detyrohen të përdorin sistemin e kontenerëve personal në mënyrë të diferencuar për mbetjet urbane, njëri prej të cilëve është për mbeturinat e rrezikshme spitalore, që i nënshtrohen një trajtimi të veçantë.

Neni 21

Dorëzimi i mbetjeve urbane

1. Sistemimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane nga familjarët dhe nga të gjithë subjektet e tjerë, bëhet vetëm në vendet publike të mbledhjes së mbetjeve urbane, që ka caktuar administratori i shërbimit ose me kontenierë individualë, që përcaktohen sipas llojit të prodhuesit, sasisë së mbetjeve dhe infrastrukturës.
Dorëzimi i tyre jashtë rregullave të përcaktuara nga bashkia, është shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.
2. Tregëtarët dhe personat e tjerë, që ushtrojnë shërbime ambulante, duhet të jenë të pajisur me koshe të posaçëm për grumbullimin e mbetjeve urbane, që u krijohen gjatë tregëtimit e shërbimit, që u ofrojnë qytetarëve.

Neni 22

Përdorimi i kontenierëve publik

1. Kanë të drejtë të përdorin kontenierët publik:
 - a. Familjet, brënda vijës së verdhë të qytetit
 - b. Bizneset të llojit tregëtar, artizanal apo shërbimesh, që prodhojnë mbetje urbane ku prodhimi ditor i çdo subjekti nuk kalon sasinë prej $\frac{1}{4}$ e volumit të një kontenieri.
2. Të gjithë bizneset apo institucionet privatë apo shtetëror që prodhojnë mbetje mbi kufizimin e mësipërm, duhet të kenë detyrimisht kontenierë individualë brënda territorit të tyre.

Neni 23

Kufizimet për dorëzimin e mbetjeve urbane

1. Dorëzimi i mbetjeve urbane është një detyrim i pa ndryshuar i prodhuesit dhe duhet të kryhet sipas mënyrave, ditëve dhe orëve të përcaktuara nga bashkia dhe operatori i shërbimit të pastrimit, si dhe mbështetur në kategorizimin e mbetjeve dhe prodhuesve të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Dorëzimi i mbetjeve që nuk konsiderohen si mbetje urbane nga kuadri ligjor i fushës dhe nga kjo rregullore, do të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga bashkia për këtë qëllim.
3. Gjatë procesit të ndërtimit, rikonstruksionit apo prishjes së objekteve, qytetarët, investitorët dhe subjektet ndërtuese, marrin masa për largimin e vazhdueshëm të mbeturinave ndërtimore.
4. Hedhja e mbetjeve ndërtimore në rrugë, në trotuare, në çdo mjedis publik, si dhe pikat që ka caktuar për mbetjet urbane, është e ndaluar dhe përbën shkelje që ndëshkohet si e tillë.

KREU IV GRUMBULLIMI, LARGIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETJEVE URBANE

Neni 24 Grumbullimi i mbetjeve urbane

1. Vendet e grumbullimit të mbetjeve (V.G.M) janë sipërfaqe të vogla, që shërbejnë për dorëzimin e mbetjeve nga prodhuesit e tyre. V.G.M. –të duhet të jenë të betonuara ose të asfaltuara.
2. V.G.M.-të ku vendosen kontenierët, kazanët apo stacionet e betonuara për grumbullimin e mbetjeve, caktohen nga bashkia. Ato duhet të jenë të vijëzuara me shenja dalluese në vendin ku duhet të qëndrojnë.
3. Bashkia miraton dhe publikon skemën konkrete të vend-ndodhjes së V.G.M.-ve, dhe strukturën e përmasat e secilës. Ndryshimi i vend- ndodhjes së V.G.M.-ve, pa miratim të administratorit të shërbimit, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.
4. Ofrimi dhe pranimi i shërbimit, është i detyrueshëm në të gjithë territorin bashkiak, duke mos përjashtuar askënd, vetëm në rastet kur bashkia autorizon forma të përkohëshme eksperimentale të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.

Neni 25 Grumbullimi i mbetjeve jo të diferencuara

1. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane në mënyrë jo të diferencuar ofrohet nga bashkia në një ose disa mënyra specifike si:
 - i. Grumbullimi nëpërmjet kontenierëve publikë,
 - ii. Grumbullimi nëpërmjet qeseve, derë më derë,
 - iii. Grumbullimi nëpërmjet dorëzimit në sheshe ekologjike,
 - iv. Grumbullimi nëpërmjet kontenierëve për hapësira private dhe të përmasave të ndryshme.
2. Prodhuesi i mbetjeve mund të depozitojë mbetjet në mënyrë individuale direkt në pikën e përcaktuar si vendhedhje i përcaktuar/ ose në pikën fundore të menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Largimi publik i mbeturinave duhet të garantojë grumbullimin e të gjithë mbetjeve urbane, që për çfarëdo lloj motivi gjenden jashtë kontenierëve, në pikat ku shërbimi kryhet “*derë më derë*”, si dhe grumbullimin e mbetjeve urbane, që gjenden të shpërndara në hapësirat publike.

Neni 26

Grumbullimi me kontenierë

1. Grumbullimi nëpërmjet kontenierëve kryhet në hapësirat publike bashkiake të banimit, bizneseve ose në oborre të shoqërive private a publike dhe në përgjithësi në të gjitha vendet ku është parashikuar një prodhim i konsiderueshëm mbetjesh urbane.
2. Zbrazja e kontenierëve kryhet sipas një grafiku të caktuar nën kujdesin e ndërmarrjeve shtetërore ose/ dhe operatorët e shërbimit, duke ja komunikuar paraprakisht prodhuesit të mbetjeve.
3. Menjëherë pas largimit të mbetjeve urbane territori përreth sheshit të kontenierëve pastrohet dhe dezinfektohet në një sipërfaqe 20 – 25 m².
4. Për asnjë rast nuk do të lejohen kontenierë të tejmbushur me mbetje urbane, të pa transportuar dhe mbetje urbane të lëna në zonën përreth kontenierëve ose në vendet e përcaktuara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, ndërmarrjet shtetërore, operatorët e shërbimit duhet të marrin masa për pastrimin e tyre.
5. Prodhuesi i mbetjes është i detyruar të përdorë kontenierin e disponueshëm, më të afërt dhe të mbyll kapakun nëse kontenieri e ka një të tillë; në rastet kur kontenieri është i tejmbushur nga qeset, mbetjet duhet të dorëzohen në kontenierin tjetër disponibël dhe nuk duhet të lihen asnjëherë në tokë.
6. Kontenierët lahen dhe dezinfektohen sipas një grafiku të miratuar nga bashkia me lëndë dezinfektuese dhe deratizuese (si psh: gëlqere të kloruar deri në 5% klor aktiv, pas zbrazjes së mbetjeve urbane):
 - i. për kontenierët publik minimalisht një herë në javë.
 - ii. për kontenierët, që qëndrojnë në ambiente të brëndshme, publike apo private, minimalisht një herë në muaj.

Neni 27

Grumbullimi me qese

1. Bashkia, në pamundësi të kryerjes së shërbimit me kontenierë publikë, mund të ofrojë shërbim alternativ të grumbullimit me qese të mbetjeve urbane në zona të caktuara urbane.
2. Përdoruesi familjar ka detyrimin të nxjerrë jashtë banesës, pranë derës ose në një vend të përcaktuar në hapësirën publike, qeset në mënyrë të dukshme, të mbyllura, në mënyrë të rregullt, për të mos krijuar pengesa apo rreziqe për kalimtarët, në orare të përcaktuar paraprakisht.
3. Mund të aplikohen pika grumbullimi të lëvizshme, që janë mjete vetëshkarkuese të hapura të tonazhit të vogël gjithmonë në orare dhe frekuencë të përcaktuar.
4. Frekuenca dhe ora e grumbullimit përcaktohet nga ndërmarrja shtetërore ose/dhe operatori i shërbimit me miratimin e bashkisë, si dhe lajmërimi i orarit bëhet nga ndërmarrja shtetërore ose/dhe nga operatori i shërbimit.

5. Qeset duhet të jenë të njëjtit lloj dhe i shpërndahen prodhuesit të mbetjeve nga ndërmarrja shtetërore ose/dhe operatori i shërbimit në proporcion me konsumin. Qeset duhet të jenë në peshë jo më të madhë se 20 kg dhe nuk duhet të kenë objekte që presin, me majë, gjithsesi mbetje të rrezikshme për personin përgjegjës për shërbimin manual të grumbullimit.

Neni 28

Grumbullimi me kontenerë të palëvizshëm

1. Mbetjet e vëllimshme dhe të ndërtimit, të prodhuara nga familjet, mund të dorëzohen dhe grumbullohen, me mënyrat e përcaktuara nga bashkia si më poshtë vijon:
 - a. nëpërmjet dorëzimit në kontenerët e palëvizshëm, me dimensione të mëdha, të vendosura për këtë lloj mbetje,
 - b. nëpërmjet grumbullimit pranë ish-përdoruesit të këtyre mbetjeve, me anë të telefonimit tek ndërmarrja shtetërore ose/dhe operatori i shërbimit,
 - c. nëpërmjet dorëzimit nga prodhuesi i mbetjeve, pranë qendrave të multigrumbullimit.
2. Në ditën e parashikuar për grumbullim, mbetja duhet të nxirret jashtë nga ish-përdoruesi, në pikën më të afërt të grumbullimit, në mënyrë që të evitohet çdo pengesë ndaj lëvizjes së mjeteve dhe /ose këmbësorëve.

Neni 29

Shërbimi i pastrimit në tregje

1. Administratorët e tregjeve, persona të veçantë apo grup personash tregëtarë që zënë vendet e shitjes në tregjet private apo publike, të organizuar në hapësirat publike ose private, duhet të administrojnë vetë pastrimin e territorit të tregut menjëherë pas mbylljes së aktivitetit ditor. Për sa i përket administratorit të mbetjeve që dalin, në këto tregje duhet të operohet si më poshtë:
 - Administratori i tregut privat apo përfaqësuesi i tregëtarëve është përgjegjës për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve për në fushën e depozitimit duke lidhur detyrimisht kontrata të veçanta me bashkinë ose operatorë privatë shërbimi të licensuar, që të garantojnë zbatimin e kushteve higjieno-sanitare të kësaj rregulloreje.
 - Në rastet e tregjeve publik, që administrohen nga bashkia, ky shërbim përfshihet në shërbimet e tjera të pastrimit që administron bashkia.
 - Detyrimisht çdo treg duhet të ketë të miratuar nga bashkia "V.G.M."-të e përkohëshme ose të përhershme, brenda territorit të tregut, për të mundësuar vendosjen e kontenerëve.
2. Të gjithë shitësat e tregut të prodhimeve bujqësore e blegtoresë, mbetjet urbane që krijojnë gjatë tregëtimit të produkteve vetiake, i grumbullojnë të palosura apo sistemuar ose të mbyllura në qese, dhe i hedhin në pikat e përcaktuara nga bashkia. Largimi nga tregu pa bërë këtë sistemim të mbetjeve konsiderohet shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Neni 30

Vendosja dhe karakteristikat e kontenierëve

1. Kontenierët parashikohen në numër të tillë, që të sigurojnë grumbullimin në kohë dhe në sasi, midis flukseve të çdo cikli dorëzimi.
2. Caktimi i Vgm-ve, duhet bërë duke respektuar kriteret e higjenës, aty ku është e mundur në një distancë prej 10 metrash, largësi (vijë ajrore) nga dyert dhe dritaret, në harmoni me infrastrukturën urbane, për më tepër me qëllim lehtësimin e largimit publik të mbetjeve. (Në raste të veçanta ku nuk mund të zbatohet distanca 10 metra për shkak të infrastrukturës urbane, Vgm-ja të rrethohet me material plastik forex ose llamarinë në 2 metra lartësi).
3. Për të gjitha ndërtimet e reja, projektet e rikonstuksioneve apo zonave të reja urbane përcaktimi dhe miratimi i vendeve të grumbullimit të mbetjeve është i detyrueshëm dhe bëhet në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues.
4. Kontenierët mund të vendosen brënda hapësirave private, brënda dyqaneve, tregjeve dhe pikave të shitjes me pakicë dhe shumicë, apo brënda institucioneve publike, shkollave dhe qendrave sportive, etj me pëlqimin/ose jo të pronarit ose administratorit si dhe me miratimin e bashkisë, në rastet e mëposhtme:
 - a) në zonat ku struktura urbanistike e bën të pamundur vendosjen e kontenierëve në hapësirat publike,
 - b) në raste të veçanta nevojash të shërbimit të largimit publik të mbetjeve, që lidhen me:
 - dëshirën e prodhuesit të mbetjes për të pasur pikë të pavarur,
 - sasinë dhe llojin e mbetjeve që prodhon, ku përfshihen dhe mbetjet jo urbane,
 - llojin e aktivitetit, etj.Në këto raste mund të ketë shtesë për tarifën e shërbimit që përfiton.
 - c) në rastet kur prodhuesi i mbetjes nuk ofron pëlqimin për të pasur kontenierë të pavarur, ai detyrohet të depozitojë mbetjet urbane në pikën më të afërt të grumbullimit kur është në përputhje me kriterin e vendosur në nenin 22 të kësaj rregulloreje, “përdorimi i kontenierëve publik” ose në të kundërt duhet të bëjë vetë dorëzimin e mbetjeve në vend-depozitim të tyre/ ose pikën fundore të trajtimit të tyre, në përputhje me normat e përcaktuara në këtë rregullore.
5. Grumbullimi i mbetjeve urbane, që krijohen nga biznesi (i vogël, i mesëm, i madh), por që nuk përfshihen në kategorinë “mbetje të bizneseve”(si p.sh tallash, xham etj), bëhet me kontenierë privatë të vendosur brënda territorit ku kryhet aktiviteti. Kontenierët privat duhet të kenë të njëjtët parametra si ata të përcaktuar nga kjo rregullore.
6. Kontenierët duhet të kenë sipërfaqe të lëmuara, material me qëndrueshmëri të lartë dhe të papërshkueshëm nga uji, material metalik (trashësi të llamarinës 1,5 – 2 mm) apo plastik, të pajisur me kapak dhe me rrota (ose këmbë fikse), të kapaciteteve të ndryshme.
7. Kontenierët mbahen gjithmonë në kushte optimale pune nga ndërmarrjet e shërbimeve komunale shtetërore ose/ dhe operatorët e shërbimit.
8. Kontenierët mund të jenë të llojeve si më poshtë vijnë:
 - a. kontenierë të brëndshëm, me kapacitet vëllimetrik, nga 120 litra deri në 360 litra

- b. kontenierë publikë urban, me kapacitet vëllimetrik, nga 700 litra deri në 3200 litra, për qëndrim jashtë;
- c. kontenierët për mbetje të vëllimshme, të palëvizshme, pa rrota, me kapacitet vëllimetrik mbi 5500 litra ose 7700 litra, për qëndrime fikse dhe procesi i zbrazjes kryhet në mënyrë mekanike;
- d. kontenierë me kompaktim, të palëvizshëm, pa rrota, me kapacitet volumetrik të madh, me vetë- kompaktim (të pajisura me sistem hidraulik apo mekanik të pavarur).

Neni 31

Ruajtja higjeno- sanitare për punonjësit e shërbimit

Për ruajtjen higjeno – sanitare të punonjësve të shërbimit të administrimit të mbetjeve, zbatohen normat në dispozicion për sigurinë dhe higjenën e punës. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me veshje të përshtatëshme dhe me mekanizma apo pajisje për mbrojtje personale, dhe duhet t'i nënshtrohet trajtimeve për kontrole sanitare të parashikuara me ligj.

Neni 32

Transporti i mbetjeve urbane

1. Transporti publik i mbetjeve urbane për në pikën fundore të menaxhimit të mbetjeve bëhet nga bashkia ose operatori i shërbimit, i caktuar nga bashkia. Operatorë të tjerë urbanë, që mund të kryejnë aktivitete pastrimi apo grumbullimi, transporti apo depozitim mbetjesh në mënyrë të pavarur nga shërbimi publik, duhet të jenë të pajisur me licensë dhe lejet përkatëse.
2. Transportimi organizohet e funksionon në orët e mbrëmjes apo herët në mëngjes.

Neni 33

Mënyra e transportimit të mbetjeve urbane

1. Transporti i mbetjeve urbane nga pikat e grumbullimit për në vendin e depozitimit e të përpunimit të tyre, bëhet me mjete teknologjike të posacme dhe të mbuluara , ngarkesa e të cilëve nuk rrezikon derdhjen apo rishpërndarjen e mbetjeve urbane.
2. Kamionët që transportojnë lëndë dhe mbetje ndërtimi ose që cojnë mbetjet ndërtimoren në vend-depozitimin e tyre, marrin masa që gjatë lëvizjes të mos ketë derdhje apo rrjedhje të mbetjeve që transportojnë.
3. Kamionët, autoveturat, etj kur hyjnë në rrugët e qytetit nga kantierët e ndërtimit dhe nga rrugët dytësore të paasfaltuara, janë të detyruar të pastrojnë gomat nga balta, llacet, betonet e çdo papastërti tjetër që ndot qytetin.



Neni 34
Peshimi i mbetjeve urbane

1. Të gjithë mbetjet e grumbulluara, përpara ose gjatë depozitimit në proceset e rekuperimit apo përpunimit final, duhet të peshohen nëpërmjet përdorimit të një sistemi peshimi rregullisht të kolauduar. Në vazhdim të operacionit të peshimit duhet të kryhen edhe regjistrimet e të dhënave.
2. Të gjitha të dhënat do të mblidhen dhe ruhen nën kujdesin e operatorëve të ndryshëm të shërbimeve dhe mund të supervizohen apo kërkohen nga bashkia me ritme periodike që përcaktohen më parë.

KREU V
ADMINISTRIMI I MBETJEVE URBANE NË MËNYRË TË DIFERENCUAR.
QËNDRA E MULTIGRUMBULLIMIT

Neni 35
Objekti i shërbimit dhe parimet e përgjithëshme.

1. Kreu aktual ka të bëjë me administrimin e pjesëve të ndryshme të mbetjeve urbane të përcaktuara në Nenin 8 dhe 19 të kësaj Rregulloreje, të cilat duhet të dorëzohen dhe grumbullohen duke respektuar dispozitat e përgjithshme dhe të veçanta në vazhdim.
2. Largimi publik i mbetjeve organizohet në mënyrë të tillë që të arrij sa më tepër të jetë e mundur objektivin e reduktimit të prodhimit të mbetjeve urbane dhe të ndarjes në burim për llojet e ndryshme të pjesëve që përbëjnë ato, duke tentuar reduktimin, me kalimin e kohës, të sasisë së mbetjes së padiferencuar jo të riciklueshëm dhe jo të rekuperueshëm.

Neni 36
Mënyrat e dorëzimit dhe grumbullimit të Mbetjeve Urbane në mënyrë të diferencuar.

1. Grumbullimi nëpërmjet kontinierëve, koshave, etj.
2. Grumbullimi nëpërmjet sistemimit të grumbullimit "derë më derë".
3. Grumbullimi nëpërmjet qendrave të multigrumbullimit dhe/ose shesheve ekologjike.
4. Sheshi ekologjik shërben për të kryer grumbullimin e fraksioneve të ndryshme të materialeve në një sipërfaqe ku janë sistemuar kontinierë të ndryshëm sipas llojit të mbetjes. Ky shesh ekologjik mund të marr karakteristikat e një qendre multigrumbullimi kur bëhet fjalë për një sipërfaqe të rrethuar, e lejueshme për përdoruesit vetëm në orare të caktuara, dhe ku për të cilën është caktuar një përgjegjës.

Neni 37 Grumbullimi i diferencuar

1. Kryerja e grumbullimit të diferencuar bëhet konform parimeve të përdorura në këtë Rregullore.
2. Për të mundësuar shërbimin e grumbullimit të diferencuar, do të bëhen publike ndaj prodhuesve të mbetjeve, vendodhja e kontenierëve dhe qendrave të grumbullimit, si dhe mënyrat e ndryshme të kryerjes së shërbimeve.
3. Prodhuesi i mbetjes, në mënyrë të detyrueshme, do të dorëzojë në mënyrë të ndarë të gjithë mbetjet urbane për të cilat është përcaktuar kryerja e shërbimit të grumbullimit të diferencuar.
4. Bashkia percakton:
 - a) Mënyrat e dorëzimit nga prodhuesi i mbetjeve, të mbetjeve dhe fraksioneve për t'u grumbulluar;
 - b) Mënyrat dhe frekuencat e grumbullimit në funksion me fraksionet e ndryshme;
 - c) Mënyrat e dhënies hua të kontenierëve, prodhuesve të mbetjeve, sipas tipologjive të veçanta;
5. Kontenierët specifik mund të vendosen brënda hapësirave private në përputhje me Nenin 22 dhe Nenin 30 të kësaj rregulloreje.
6. Çerdhet, kopshtet dhe shkollat publike e private, mund të përdorin sistemin e disa koshave për të edukuar nxënësit me normat e rregullat bashkëkohore të trajtimit të ndarë të mbetjeve urbane.



Neni 38

Standartet për grumbullimin e mbetjeve urbane nëpërmjet kontenierëve

Për grumbullimin e mbetjeve urbane, nëpërmjet kontenierëve, standartet minimale që duhen ndjekur për organizimin e tyre janë si më poshtë vijon:

<u>Materiale për Grumbullim</u>	<u>Volumi në litër i Kontenierit/Banorë</u>	<u>Distance e Kontenierit nga Përdoruesi (m)</u>	<u>Ritmi i Grumbullimit</u>
Qelqi	5	1000	15-ditor
Letra	10	1000	15-ditor
Plastika	5	1000	15-ditor
Kanaçet metalike	0.4	1000	Mujore
Pila, bateri	0.03	-	Mujore
Ilace	0.15	-	Mujore
Mbetje Urbane të Rrezikshme	0.1	-	Mujore
Mbetje Urbane	25	250	3 herë në javë
Fraksioni i thatë	20	250	2 herë në javë
Fraksioni organik	5	250	2 herë në javë

Neni 39

Grumbullimi i mbetjes së paricikueshme dhe të parrezikueshme

Mbetjet e paricikueshme dhe të parrezikshme përfshijnë, llojet e mbetjeve në vijim; hedhurina ushqimore nga gatimet, mbetje (teprica) ushqimesh, ushqime të prishura, lëvozhga vezësh, mbetje perimesh dhe frutash, llumra kafeje, filtra të çajit, lule të vyshkura dhe bimë shtëpiake, letër prej celuloze të pastër, hi të fikur nga furrat, sobat apo oxhaqet, kocka të vogla dhe gjëra të ngjashme.

Neni 40

Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme dhe të parrezikshme

1. Mbetjet e riciklueshme dhe të parrezikshme përfshijnë letrën, kartonin, qelqin, plastikën, kanaçet metalike, veshjet, si dhe materialet e tjera të konsideruara si të recuperueshme. Për këto lloje mbetjesh mund të përcaktohen mënyra grumbullimi të ndryshme, nëpërmjet grumbullimit "derë më derë" ose nëpërmjet kontenierëve.
2. Kontenierët e caktuar për këto lloj mbetjesh do të vendosen në mënyrë të tillë, që të bëjnë të mundur dorëzimin nga ana e prodhuesve të të gjitha materialeve të riciklueshme në të njëjtën pikë grumbullimi, qe konfigurohet si shesh ekologjik apo qëndër multigrumbullimi/stacion transferimi.

3. Për përdoruesit që prodhojnë sasi të mëdha të këtyre mbetjeve, si shkolla, shtëpi pushimi ose komunitete, aktivitete ekonomike ose të ngjashme, mund të organizohet një shërbim grumbullimi me kontenierë të përshtatshëm për objekte apo godina specifike.
4. Mund të aplikohet “grumbullim multimaterial”, si grumbullim i përbërësive të ndryshëm (p.sh. qelq – kanaçe, ose qelq – kanaçe – plastikë) që mund të mblidhen në një lloj kontenieri të vetëm, për t’u ndarë më pas në mënyrë mekanike gjatë fazave të tjera të rekuperimit.

Neni 41

Grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme familjare.

Grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme, të prodhuara nga ekonomitë familjare, kryhet me kontenierë të përshtatshëm, të vendosur sipas përcaktimit nga Bashkia.

Neni 42

Grumbullimi i mbetjeve të vëllimshme

Mbetjet e vëllimshme, mund të dorëzohen dhe grumbullohen, me mënyrat e përcaktuara nga bashkia, si më poshte vijojnë:

- a. Nëpërmjet grumbullimit pranë prodhuesit të mbetjeve, me anë të telefonimit tek ndërmarrja shtetërore ose operatori i shërbimit;
- b. Nëpërmjet grumbullimit rrugë më rrugë, e kryer sipas frekuencave të përcaktuara nga bashkia;
- c. Nëpërmjet dorëzimit pranë qendrave të multigrumbullimit.

Neni 43

Qëndrat e multigrumbullimit / stacioni i transferimit

1. Qëndrat e multigrumbullimit kanë si qëllim atë të promovimit, duke shqyrtuar kriteret ekonomike dhe të efikasës, të sistemeve me prioritet drejt rikuperimit nga mbetjet të materialeve dhe energjisë.
2. Llojet e mbetjeve që grumbullohen pranë qendrave të multigrumbullimit duhet të tregohen në tabelat sinjalizuese përkatëse të vendosura në hyrje të tyre, të shprehura si me poshtë vijon:
 - Bimore;
 - Dru;
 - Letër dhe karton;
 - Qelq;
 - Metale;
 - Të mira të qendrueshme;
 - Të vëllimshme;

- Plastikë;
 - Bateri, pila;
 - Ilaçe të skaduara;
 - Mbetje të rrezikshme (me preardhje shtëpiake);
 - Akumulator plumbi (me preardhje shtëpiake);
 - Vajra minerale dhe bimore te papërdorshëm (me preardhje shtëpiake);
 - Pneumatik (me preardhje shtëpiake);
 - Inerte nga prishjet, ndertimet dhe germimet (me preardhje shtëpiake).
3. Bashkia ka të drejtën e prezantimit ose modifikimit, në çfarëdo momenti, të grumbullimit të diferencuar për llojet e ndryshme të mbetjeve, që do të pranohen në qendrat e multigrumbullimit ose në stacionin e transferimit.
 4. Në rastet kur kryhen shërbime plotësuese për grumbullimin e mbetjeve speciale të përbërë nga material të pranueshme në qendrat e multigrumbullimit, prodhuesit e tyre mund t'i dorëzojnë ato sipas një marrëveshje, kontrate, të lidhur me të, në respektim të kushteve të përmendura në këtë rregullore.
 5. Prodhuesit jo shtëpiak të mbetjeve mund të dorëzojnë mbetjet e tyre pranë qendrave të grumbullimit vetëm me autorizim të lëshuar nga Bashkia, pas një kërkesë të paraqitur më parë nga përdoruesi. Bashkia ka të drejtën e përcaktimit, nëpërmjet masave paraprake, të mënyrave me anë të së cilave prodhuesit e mbetjeve jo shtëpiake duhet të marrin pjesë në shpenzimet e qendrës së multigrumbullimit në funksion të llojit të mbetjes urbane dhe sasisë së mbetjes së dorëzuar.

Neni 44

Hapja e qendrave të multigrumbullimit.

Mbetjet urbane mund të dorëzohen në ditët dhe oraret e vendosura nga operatori i shërbimit dhe të paraqitura me sinjalistikën përkatëse, në hyrje të qendrës multigrumbulluese.

KREU VI TARIFAT



Neni 45

Vjelja e tarifës

1. Tarifa e pastrimit vilet nga autoritetet e bashkisë për mbulimin e shpenzimeve të mbledhjes, largimit e trajtimit të mbetjeve dhe pastrimin e qytetit.
2. Autoritetet e bashkisë duhet të përcaktojnë vetë ose mund të ngarkojnë një palë të tretë, për përlllogaritjen e tarifave, hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për këto tarifa, marrjen dhe transferimin e tyre, lëshimin e vërtetimeve për autoritetet e bashkisë, perpunimin e të dhënave të kërkuara dhe vënien në dijeni nga kjo palë e tretë, të autoriteteve.

3. Tarifat vilen për pastrimin e qytetit, për vënien në gjendje pune dhe përdorimin e impianteve për largimin, transportimin, depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve.

Neni 46 **Taksapaguesit**

1. Niveli i tarifës përcaktohet me një vendim të veçantë të Këshillit Bashkiak.
2. Vendosja e tarifës së pastrimit, pagesa dhe vjelja e saj kryhen sipas vendimit të Këshillit Bashkiak për tarifën e pastrimit.
3. Bashkia mund të aplikojë tarifa të ndryshme sipas llojeve të ndryshme të prodhuesve, duke u bazuar në shërbimin që përfitojnë, sasinë dhe llojin të mbetjeve që gjenerojnë. Mund të aplikohen gjithashtu pagesa shtesë mbi tarifën për biznese të veçantë ku lloji dhe sasia e mbetjeve që prodhojnë, nuk mund të përballohet nga shërbimi i largimit publik i mbledhjes së mbeturinave.
4. Për këto biznese mund të aplikohen zbritje të tarifës nëse marrin vetë përsipër largimin e mbetjeve. Në këtë rast mund të aplikohet vetëm tarifa për depozitimin e mbetjeve në fushat e trajtimit të tyre.
5. Për çdo ndryshim të masës së tarifave shpallet një vendim ndryshimi. Afati i tarifës së re përcaktohet në vendimin e ndryshimit. Mbipagesat trashëgohen.

KREU VII **MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN**

Neni 47 **Detyrimi për informim**

1. Bashkia bën publike skemën e pastrimit, oraret e pastrimit dhe oraret e preferueshme për dorëzim dhe largimin publik të mbeturinave.
2. Në procesin e vendimmarrjes për caktimin e vend-depozitimeve për njësi kompostimi dhe për shfrytëzimin e tyre, ftohen të marrin pjesë OJF-të mjedisore dhe publiku i interesuar.
3. Kushdo ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurinë e procesit të largimit publik të mbeturinave, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara për këtë çështje.
4. Personat fizikë e juridikë që janë angazhuar në largimin publik të mbetjeve, që kanë dhe përdorin vend-depozitime apo njësi të kompostimit, publikojnë të dhënat që u rezultojnë nga monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarive të tyre, jo më rrallë se një herë në tre muaj.

Neni 48 **Fushatat sensibilizuese dhe informuese**

1. Bashkia kujdeset për fushatat e nevojshme të edukimit, sensibilizimit dhe stimulimit për bashkëpunimin me komunitetin.

2. Në mënyrë periodike kryhet një reklamim në masë të gjerë, nëpërmjet materialeve gjithëpërfshirëse, i rezultateve cilësore dhe sasiore të arritura gjatë viteve paraardhës, në vecanti për grumbullimin në mënyrë të diferencuar të mbetjeve, me qëllim pjesëmarrjen aktive të komunitetit.
3. Në mënyrë periodike shpërndahet falas një broshurë me orientime, udhëzues për dorëzimin e duhur të materialeve të ndyshme, për përdorimin e konteniereve dhe vendndodhjen e tyre; ndër të tjera do të jepen edhe orientime mbi pjesët që grumbullohen, mënyrat e dorëzimit, destinacionet e tyre, mbi arsyet, nevojat dhe pretendimet a bashkëpunimit të qytetarëve.
4. Duhet të promovohen, nga drejtoritë përkatëse në Bashki, sipas rastit në bashkëpunim me personat juridik të përfshirë, fushata edukimi dhe informimi drejtuar qytetarëve me synim specifikimin mbi:
 - Llojet e mbetjeve për të cilat është aktivizuar shërbimi i diferencuar;
 - Qëllimin dhe mënyrat e kryerjes së shërbimeve;
 - Destinacionet e fraksioneve që rekuperohen;
 - Detyrimet dhe detyrat për dorëzimin në mënyrën e duhur të mbetjeve;
5. Në mënyrë të veçantë promovimi mund të realizohet:
 - Nëpërmjet tabelave pranë pikave të grumbullimit;
 - Nëpërmjet komunikimeve në shtyp;
 - Nëpërmjet fletpalosjeve të shpërndarë tek përdoruesit e interesuar;
 - Nëpërmjet formave të tjera të shpërndarjes së materialeve informuese.
6. Personi juridik, (operator i shërbimit), është i detyruar të komunikoj çdo lloj ndryshimi në lidhje me mënyrat e kryerjes së shërbimit tek përdoruesit e interesuar me një paralajmërim me shkrim, minimum 7 ditë.

Neni 49

Bashkëpunimi me organizma jo fitimprurëse

1. Në aktivitetin e administrimit të mbetjeve urbane, Bashkia mund të shfrytëzojë bashkëpunimin e shoqatave të vullnetarizmit, OJF-ve, pjesëmarrjes së publikut, etj.
2. Organizatat jo fitimprurëse kryejnë kontribute të nevojshme, me qëllim sensibilizimin e komunitetit, ndihmën në grumbullimin në mënyrën e duhur të mbetjeve ose pastrimin e qytetit, të frymëzuara nga qëllime mjedisore, pa qëllime përfitimi duke përdorur aktivitete vullnetarizmi apo projekte.
3. Organizatat jo fitimprurëse mund të përfshihen edhe në grumbullimin e pjesëve specifike të rekuperueshme të mbetjeve urbane, pas nënshkrimit të marrëveshjeve me Bashkinë, me paraqitjen e kërkesave të nevojshme që tregojnë mënyrat e kryerjes së grumbullimit, llojet e materialeve që grumbullohen dhe destinacioni i tyre, për më tepër edhe mjetet që do të përdoren për kryerjen e shërbimit me qëllim garantimin e higjenes dhe sigurisë së punës që do të kryhet.
4. Organizatat jo qeveritare autorizohen nga Bashkia, e cila përcakton vendin dhe mënyrat e ndërhyrjes, etj.

KREU VIII

ORARET E HEDHJES SË MBETJEVE PËR FAMILJARËT, ENTET PUBLIKE DHE BIZNESET

Neni 50

Oraret e hedhjes së mbetjeve urbane do të jenë:

- Për familjarët dhe Entet Publike orari i hedhjes së mbetjeve do të jetë nga ora 06:00 deri në orën 23:00.
- Për subjektet private, bizneset, orari i hedhjes së mbetjeve do të jetë nga ora 23:00 deri në orën 04:00.

Bazuar në pikën 1 të nenit 19 të kësaj rregullore: bizneset si supermarketet, restorantet, hotelet, familjet, subjektet private dhe publike, që krijojnë mbetje gjatë veprimtarisë së tyre, të natyrës si si :

- a. Mbeturina ushqimore (organike, nga restorantet etj)
- b. Amballazhe (plastike, qelq, letër, karton, vecanerisht nga marketet supermarketet etj)
- c. Metalike të përmasave të vogla.

Dorezimi ditor i mbetjeve urbane në nje volum me te madh se $\frac{1}{4}$ e volumit te nje konteneri publik është i ndaluar me ligj, për rrjedhojë të gjitha bizneset apo institucionet privatë apo shtetëror që prodhojnë mbetje mbi kufizimin e lejuar, duhet të kenë detyrimisht hapësirë individuale brënda territorit të tyre ku kryhet aktiviteti, dhe duhet të mbledhin në formë të veçantë me qese ose kosha ngjyra të ndryshme ose me mbishkrime të dukshme që orientojnë hedhjen e veçuar të mbetjeve urbane të sipërcituara.

KREU IX

NDALIMET, KONTROLLI DHE SANKSIONET

Neni 51

Ndalime dhe detyrime

1. Shkeljet ndaj Rregullores, përbëjnë kundravajtje administrative dhe ndëshkohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe sic është përcaktuar në rregullore.
2. Përveç ndalimeve të shprehura qartë e Rregullores :
 - a) Është e ndaluar hedhja, derdhja dhe depozitimi në hapësirat publike, në të gjithë territorin bashkiak, në tregjet publike të hapura apo të mbuluara, e çdo lloj mbetje, papastërti, hedhurinë e ngurtë, gjysëm e ngurtë, e lëngët dhe në përgjithësi materiale mbetjesh dhe hedhurinash të çdo lloji, natyre dhe dimensionit, edhe pse e mbyllur me qese. Ky ndalim është në fuqi edhe për sipërfaqet ujore, lumenjtë, kanalet, burimet e ujit, gropat, brigjet anët e rrugëve, etj;

- b) Është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve urbane në vendet e zbuluara të hapësirave private, në trojet e sheshet, prona të rikthyera, të rrethuara ose jo, në të cilat nuk ka filluar ndonjë veprimtari ndërtimore apo e çdo natyre tjetër. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbeturinave;
- c) Cilido që shkel ndalimet e përmendura më sipër është i detyruar të kryejë largimin e mbetjeve. Ky veprim duhet të kryhet nga pronari apo presioni me të drejta të deleguara mbi hapësirën e ndotur. Kryetari i Bashkisë cakton operacionet e nevojshme dhe afatet brënda të cilave duhet të veprohet, si dhe periudhen kohore për shlyerjen e dëmit monetar;
- d) Është e ndaluar për qytetarët dhe për këdo person të pautorizuar, të kryejë çdo lloj selektimi manual të mbetjeve të dorëzuara brënda kontenierëve, kërkimi apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenierë, ose pranë impianteve të rekuperimit dhe përpunimit final;
- e) Në rastet e shërbimit të grumbullimit “derë me derë” është i ndaluar ekspozimi i qeseve dhe /ose kontenierëve shtëpiak që kanë mbetje, përgjatë rrugës së grumbullimit, në ditë të ndryshme dhe jashtë orareve të përcaktuara nga Bashkia;
- f) Është e ndaluar hedhja në kontenierë apo në pajisjet e përdorura për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, të mbetjeve të lëngëta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mirë, të substancave të ngrohta apo ndezëse, për më tepër mbetje të forta, që mund të dëmdojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik;
- g) Është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve të vëllimshme në pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane, veprim që mund t'i shkaktojë dëmtime kontenierit ose mjeteve të grumbullimit, apo personave përgjegjës për shërbimin;
- h) Është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve të ndërtimit në pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane, në konteniere apo pranë tyre, si dhe në vende të tjera, të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këto rregullore;
- i) Është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve në territore publike, brënda vijës së verdhë të qytetit, duke rënë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë rregullore;
- j) Është e detyrueshme për të gjithë prodhuesit dhe mbajtësit e mbetjeve urbane, nëse këto të fundit janë objekt i grumbullimit të ndarë me qëllim rekuperimin e materialeve dhe energjisë, të dorëzojnë këto materiale në përputhje me menyrat e caktuara në shërbimet respektive;
- k) Është i ndaluar spostimi i kontenierëve apo pikave të grumbullimit, paisjeve të përdorura për shërbimin e grumbullimit, dëmtimi apo përmbyjsja;
- l) Janë të ndaluara sjelljet, që shkaktojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e shërbimit, duke përfshirë edhe parkimin e mjeteve pranë kontenierëve apo në hapësirat e manovrimit të mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mjeteve apo shërbimit të fshirjes;
- m) Është e ndaluar hedhja e mbetjeve të vogla në hapësira publike apo për përdorim publik (lëkura frutash, letra apo copa letrash, cigare, kuti shishe dhe të ngjashme);
- n) Është i ndaluar dorëzimi, tek shërbimi i grumbullimit, i kafshëve të ngordhura;
- o) Është i ndaluar dorëzimi tek shërbimi i grumbullimit i mbetjeve speciale, për të cilat nuk është lidhur një marrëveshje e përshtatshme;

- p) Djegia e mbetjeve urbane në kontenierë, rreth tyre dhe në çdo ambient tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë, sepse gazet e tymrat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut.
- q) Ndalohet kullotja e kafshëve barngrënëse në mbetjet urbane të kontenierëve e në pikat e grumbullimit të tyre, si dhe marrja prej mbetjeve të ushqimeve për kafshët si mbetje buke, etj.
- r) Nuk pranohet e drejta për të kërkuar përjashtimin nga shërbimi i zakonshëm pa miratimin e Bashkisë.
- s) Është e ndaluar dorëzimi i mbetjeve nga aktivitete prodhimi, përpunimi, trajtimi etj, si dhe mbetje te papranushme të përcaktuara në këtë rregullore ,në kontenierët publik apo në V.g.m-të.

Neni 51 Kontrolli

1. Përveç kompetencave të Organizmave përgjegjëse me ligj për kontroll, Bashkia do të aktivizojë mbikëqyrjen për të respektuar Rregulloren duke aplikuar sanksione administrative të parashikuara në të.
2. Autoritet e caktuara për kontroll janë të autorizuar të kryejnë të gjitha inspektimet që mendojnë të nevojshme, për të vërtetuar respektimin e normave të caktuara në rregullore.
3. Bashkia ka të drejtën të kërkojë nga prodhuesit e mbetjeve speciale të paraqesin dokumentacionin vërtetues të prodhimit apo përpunimit që kryhet.
4. Në rastet e vërtetimit për mosrespektim të rregullores, Bashkia nëpërmjet një akti të motivuar nga arsye sanitare, higjienike dhe mjedisore, vendos kryerjen e punimeve të nevojshme, barrë kjo në ngarkim të subjektit përgjegjës për ndotje. Gjithashtu urdhëron adaptimin e masave oportune për të parandaluar përsëritjen e mosrespektimit të rregullores, si dhe marrjen e masave penalizuese sipas normativave në fuqi.
5. Në rastet e lënies së mbetjeve në hapësirat publike ose përdorim publik, ku nuk është identifikuar subjekti përgjegjës për ndotje, Bashkia kryen me shpenzimet vetiake grumbullimin e mbetjeve dhe përpunimin e mëtejshëm.

Neni 52 Sanksionet

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje, përbëjnë kundravajtje administrative dhe dënohen sipas përcaktimeve në Aneksin “A” bashkangjitur rregullores.

ANEKSI “A”

Sanksionet

Për kundravajtje ndaj kësaj rregulloreje, aplikohen sanksionet administrative sipas modaliteteve dhe mënyrave të parashikuara si më poshtë vijon:

<i>Referuar</i>	<i>Shkelja</i>	<i>Sanksioni administrativ</i>
<i>Neni 33, paragrafi 112. 113</i>	<i>Ndotja me dhe' e baltë e rrugëve dhe trotuareve gjatë transportit ose punimeve në kantieret e ndërtimit</i>	10.000 leke/m2 50.000 leke/m2 (në mënyrë të përsëritur)
<i>Neni 50, paragrafi 173</i>	<i>Shkarkimi, depozitimi i mbetjeve nga makinat e madhësive të</i>	100.000 leke/m2

	ndryshme, në <i>territore publike</i> brënda vijës së verdhë	
<i>Neni 50, paragrafi 179</i>	Djegja e mbetjeve urbane në kontenierë, në Vgm-të, ne territore private dhe publike brenda vijes se verdhe te qytetit	Persona fizike ; 10.000 leke Persona juridike dhe operatorë shërbimi : 100.000 leke
<i>Neni 14, paragrafi 53</i>	Dorezimi (hedhja) <i>i mbetjeve</i> , apo mbetjeve nga shërbimi i pastrimit, <i>ne pusetat e elektrikut, ujesjellesit, basenet ujore</i>	10.000 leke
<i>Neni 19, paragrafi 65</i> <i>Neni 23, paragrafi 77</i> <i>Neni 50, paragrafi 171, 172</i>	Dorezimi i mbetjeve te vellimshme, mbetjeve te ndertimitne konteniere apone <i>vendet e grumbullimit te mbetjeve urbane</i>	Personat fizike: 5.000 leke/m2 Personat juridik: 10.000 leke/m2
<i>Neni 22, paragrafi 72</i>	Dorezimi ditor i mbetjeve urbane ne nje volum me te madh se ¼ e volumit te nje kontenieri publik	5.000 leke Ne menyre te perseritur: 10.000 leke
<i>Neni 50, paragrafi 170</i>	Dorezimi ne konteniere apo ne mjetet e perdorura per grumbullimin e mbetjeve, <i>i mbetjeve te lengeta, me qese te zgjidhura apo te palidhura mire, i substancave te ngrohta, ndezese, te rrezikshme per me teper mbetje te forta apo kafshe te ngordhura</i>	Persona fizike: 5.000 leke Persona juridike: 10.0000 leke
<i>Neni 50, paragrafi 183</i>	Dorezimi i mbetjeve nga aktivitetet prodhimi, perpunimi, trajtimi, etj si dhe mbetje ta papranueshme te percaktuara ne rregullore, <i>ne kontenieret publike apo ne V.G.M.-te</i>	5.000 leke/m2 Ne menyre te perseritur: 10.0000 leke/m2
<i>Neni 17, paragrafi 60</i>	Hedhja, derdhja ne trotuare e ujeravedhe mbetjeve te ndryshme nga pastrimi <i>apo larja e lokaleve te shërbimit, te dyqaneve , etj</i>	5.000 leke/m2
<i>Neni 26, paragrafi 89</i>	Dorezimi i mbetjeve urbane jashte konteniereve	Persona fizike: 2.000 leke/m2 Persona juridik: 5.000 leke/m2
<i>Neni 15, paragrafi 55</i> <i>Neni 21, paragrafi 71</i>	Hedhja e mbetjeve te castit, amballazhe etj, <i>ne trotuare, ambiente publike, apo hapësira të gjebera. Mungesa e koshit të posaçme pranesubjektit te shërbimit</i>	Persona fizike: 2.000 leke Persona juridike: 5.000 leke
<i>Neni 29, paragrafi 99</i>	Dorezimi i pasistemuar, i papalosur apo i pambyllur ne qese, <i>i mbetjeve tregetare,</i> si dhe mosdorezimi i tyre <i>në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga Bashkia</i>	5.000 leke/m2

Neni 23, paragrafi 74 Neni 27, paragrafi 92 Neni 50, paragrafi 169	Ekspozimi i qeseve me mbetje apo konteniereve shtepiak, pergjate diteve, ne dite dhe orare te ndryshme nga ato te percaktuara nga bashkia	Persona fizike: 2.000 leke Persona juridike: 5.000 leke
Neni 11, paragrafi 41,44 Neni 50, paragrafi 166	Mos kryerja e pastrimit - Te territorit apo vendit te punes pas mbarimit te aktivitetit, per tregjet apo tregetaret ambulante - Para lokaleve apo vendit te punes ne gjeresi 2-5 m	Personat fizike: 2.000 leke Personat juridike: 5.000 leke
Neni 11, paragrafi 39,44	Moskryerja e pastrimit , apo lejimi i ndotjeste territoreve private te zbuluara	5.000 leke/m2
Neni 50, paragrafi 168	Kryerja e selektimit manual, kerkimit apo marrje te mbetjeve te dorezuara ne konteniere, etj nga persona te paautorizuar	5.000 leke
Neni 50, paragrafi 175 Neni 24, paragrafi 80	Ndryshimi abuziv i V.G.M.-ve apo kontenierëve, të përcaktuara nga bashkia	5.000 leke Ne menyre te perseritur 10.000 leke
Neni 50, paragrafi 176	Parkimi i mjeteve para ose prane pikave të grumbullimit të mbetjeve ose në hapësirat e manovrimit të mjeteve të pastrimit	5.000 leke
Neni 50, paragrafi 175	Dëmtimi i pjesshëm apo total i kontenierit. Vjedhja e kontenierit	10.00 – 30.000 leke 10.01 Dëmshperblim për shkallën e dëmtimit të kazanve

Hartoi Grupi I Punës: Ardian Iljazaj

Leonard Haka

Alfred Dhuli

Soren Dedja

Krisel Koça

Jerina Maloku

Kamela Braho

Vasip Çopa

Ermal Kapllani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 427 prot.



Durrës, më 16 05 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



BASHKISË DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.41 datë 09.05.2022
“Për miratimin e rregullores së administrimit të mbetjeve në Bashkinë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016
“Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

